[RILINDASI]
Suplement i SHQIPTARJA.com

E diel
24 shtator 2017
Viti **VII** - Nr: **38**
e-mail: rilindasi@gmail.com

Kryeredaktore;
Admirina Peçi

Shtëpia e artistit...

Në Shkodër mes thesareve të shtëpisë muze të Zef Jubanit

Shtepia Muze e Zef Jubanit

NGA **Pjeter Logoreci**

Gjatë shetitjes në qytetin verior të Shkodres, syrit të vizitorit nuk i shpëtojnë ndryshime të shumta në rrugët kryesore të qytetit (që tashti janë të gurta), po ashtu edhe në stilin e ngjyrën e fasadave të reja, të rikonstruktuara apo të përshtatura nga arkitektët, në mes tradicionales dhe modernes. Në rrugicat e ngushta që degëzojnë nga shetitorja në drejtim të periferisë, vazhdojnë, aty këtu, të qëndrojnë në këmbë mure të lartë, të mbuluar me shermashek apo lule vile, karakteristike për shtëpitë qytetare shkodrane. Dyer të vjetra e të mëdha prej druri, mbyllin oborre të mbushur me trëndafila e lule të shumëllojshme e shumëngjyrash, apo ndonji cardak karakteristik i cili "vuan" nga pesha e kohës apo nga mungesa e banorëve, të cilët kanë emigruar.

Ndërsa pres kafen e mëngjezit, në një lokal pothuejse në pikën zero të qytetit, më kuriozon "misteri" i një shtëpie tradicionale catia e së cilës shihet pas murit të lartë me gurë zalli në krah të kafenesë. Kjo ndertesë, e cila mban mbi kurriz peshën e dy shekujve, është foleja ku lindi dhe u rrit ylli i skenës teatrore, aktori shkodran Zef Jubani. Shtëpia edhe pse me vlera të mëdha etnografike, historike e arkitekturore, sot, nuk është një muze i hapur për të gjithë, por një banesë normale private, pjesë e inventarit të objekteve me vlerë dhe të mbrojtura të qytetit, qysh prej viteve 60-të.

vijon në faqet 14-15

Kujtimet e Simon Rrotës/ Shtëpinë e Zef Jubanit e ndërtuen mjeshtra dibranë shumë të njohur...

Kujtimet e familjes/Ndër odat e mëdha, mblidheshin miq, shfaqej film, e ndigjohej muzikë...

Adil Zeka

Adil Zeka, ndahet nga jeta autori i 'Agushit që shëtiste botën'...

Në mbrëmjen e vonë të 13 shtator-it 2017, papritur por shpejt, ndërroi jetë në moshën 81 vjeçare, nga një sëmundje e rëndë, shkrimtari për fëmijë e të rinj Adil Zeqir Zeka (01.06.1936 – 13.09.2017), siç është quajtur nga kritika jonë letrare: klasiku i fundit, veçanërisht për prurjen në poezinë parashkollore.

Adilin e njoha, jo vetëm pse prej shumë vitesh jetonim në një qytet (në Shkodër), ishim miq (ndonëse me diferencë moshe), takoheshim pothuajse çdo ditë,.....

NGA **Xhahid Bushati**

faqe 20

Idriz Balani

Idriz Balani, në atelienë, ku ngjizen heronjtë e Kosovës

Në studjon e skulptorit Idriz Balani në Durrës është në përfundim e sipër shtatorja monumentale e heroit kombëtar Adem Jasharit. Kjo vepër është porositur dhe tenderuar nga komuna e Lipjanit në Kosovë dhe do të vendoset atje në një nga sheshet kryesore. Lidhur me këtë vepër skulptori Idriz Balani thotë se për realizimin e shatores ka kapërcyer shume vështirësi teknike dhe emocionale, pasi ai pasi fitoi tenderin me paraqitjen e bocetit...

NGA **Mark Brunga**

faqe 18-19

UDHËTIM | TRASHËGIMI

Oxhaku Oriental dhe djepi

Shtëpia e artistit...

Në Shkodër mes thesareve të shtëpisë muze të Zef Jubanit

Shtëpia Muze Zef Jubani, që gjindet në rrugën kryesore të qytetit ose në rrugicën Ndoc Coba, ka një histori afro 200 vjeçare dhe është ndërtuar për ti shërbyer familjes shkodrane të Zef Mesit...

NGA **PJETER LOGORECI**

vijon nga faqja 13

.....Përballja me derën e madhe të oborrit dhe avullinë e lartë shekullore, deshmitare të shumë ndryshimeve historike në qytet, më zgjuan dëshirën që ta vizitoj këtë shtëpi, që të shkruaj dicka për të sjell në kujtesën e bashkëqytetarëve këtë vlerë pothuajse të lënë në harresë. Edhe më përpara kam shkruar për disa shtëpi karakteristike të Shkodres, të cilat i kam njohur privatisht në periudha të ndryshme të jetës, si: shtëpinë e Pashko Vasës, shtëpinë e familjes Ceka apo atë të Gurakuqit. Kësaj here, i shoqëruar nga të zotët e shtepisë, nipat e aktorit Zef Jubani, Cini dhe Viktori (të cilët i falenderoj miqësisht), pata mundësinë të përjetoj momente të bukura e krenari për këto vlera që Shkodra ka trashëguar nëpërmes këtyre familjeve në zë.

SHTËPIA MUZE ZEF JUBANI

Shtëpia Muze Zef Jubani, që gjindet në rrugën kryesore të qytetit ose në rrugicën Ndoc Coba, ka një histori afro 200 vjecare dhe është ndërtuar për ti shërbyer familjes shkodrane të Zef Mesit. Sipas familjareve, tregëtari Mati Mesi (pasardhësi i Zefit), i cili vazhdoj traditën e familjes së tij, bënte tregëti me shumë vende në rajon. Ai ishte një burrë me kulturë përendimore pasi ishte i shkolluar në Venezia. Përvec se tregëtar, Matia njihej dhe si koleksionist i librave dhe fotografive me vlerë të cilat i blinte gjatë udhetimeve të tija jashtë vendit. Ai zotëronte disa gjuhë dhe instrumenta muzikorë dhe ishte ndjekës e pjestar i ahengut dhe grupeve muzikore shkodrane, ku më vonë do të bënte pjesë dhe dhëndrri i tij Cin Jubani. Pas vdekjes në moshë të re (nga zemra) të Matisë, vajza e tij e vetme Roza, nëna e aktorit Zef Jubani, u martua me Cin Jubanin që vinte nga një familje e mesme qytetare, i cili e trashëgoj shtëpinë në fjalë.

Që në pamje të parë kuptohet se për mirëmbajtjen e shtëpisë nuk është bërë shumë nga shteti. Vetëm pullazi i shtëpisë është rikonstruktuar nga ndërmarrja e Monumenteve të Kulturës në vitin 2005-së, por në pjesët e mbrendëshme edhe pse ka disa probleme, nuk është punuar. Kati i sipërm i ndërtesës ka 5 dhoma të cilat ndërlidhen njëra me tjetrën nëpermes një cardaku i cili deri nga fillimi i shekullit të kaluar ishte i hapur, por për nevojat e familjes është mbyllur dhe përdorur si sallon. Sipas kujtimeve të piktorit të madh Simon Rrota në ditarin e tij, shkruhet se pas termetit të vitit 1905, u bë e domosdoshme riparimi i shtëpive. Shumë familje shkodrane duke parë nga ana praktike shfrytëzimin sa më të mirë të hapsirave të shtëpive (edhe si pasojë e rritjes së fëmijëve), mbyllen hapsirën e stërmadhe të cardakut duke e ndarë atë në siperfaqe të banueshme e dhoma për familjarët.

Nga kujtimet e Simon Rrotes: "Rindërtimi vazhdonte gjithnji, por jo ma me atë stilin e vjetër, e nevoja e madhe për ambiente bani me transformue shtëpitë, tue mbylle cardaqe të kotme, tue hjekë musandra e trapazana (Musandra: rafta të mdhej në qoshe të dhomës për me vendose dyshekë, jorgana, shilte, jastëke etj., gjana për fjetje. Trapazan: lloj mensolete druri e gdhendun qi zente pjesën e sipërme të nji faqe muri, përmbi musander, për me vendosë rraqe të ndryshme qi ka shpija, faqja e përparme e mbyllun me drrasë bojë të mbylltë të gdhendun), qi nuk nepshin kurrfarë dobije."

Në një pikturë të varur në sallonin e shtëpisë me autor vëllaun e aktorit, Mati Jubanin, vërehet pamja e plotë dhe origjinale e ndërtesës, ashtu sic ishte ndërtuar në fillim, ku për tu ngjitur në katin e sipërm shërbente një shkallë me gurë të latuar me harqe e qemerë.

Kati përdhes është ndërtuar për të shërbyer si bodrum ose ahur dhe komunikon me pjesën e banuar me një shkallë të mbrendëshme. Ahuri është i ndarë në disa pjesë, për ti mundësuar familjarëve vendosjen e objekteve të përdorimit shtëpijak, ushqimeve, pijeve, e sendeve të tjera. Në mes mureve të lartë, gjëlberon

Shtepia e Mati Mesit

Zef Mesi me bashkëshorten

Shtepia Muze e Zef Jubanit

një oborr i mbushur me lule dhe pemë, ku dikur nuk mungoni dhe objekte të tjera si: kulla e sanës, jerevija, pusi apo lugu për larjet e rrobave.

Pesë dhomat (odat) e shtëpisë janë: oda e zjermit, oda e bukës e tri oda gjumit, të gjitha të stolisura me punime druri (lisit apo qershije) të gdhendur. Nga druri i gdhendur janë: raftet e murit (musandrat), kapaket e dritareve, pjesët e sipërme të murit (sergjijat) dhe tavanet ku varen ndricues plot elegancë, të një cilësie të lartë, të prodhuar në perëndim. Dy nga odat janë paisur me oxhakë të bardhë tradicional të punuar me mjeshtri në gips. Po ashtu nuk mungojnë objekte të tjera karakteristike si djepi në dru të gdhendur e ngjyrosur me motive të ndryshme ku u rriten të gjithë fëmijët e familjes, por edhe arka e pajës prej drurit me motive të pikturuara.

Nga kujtimet e Simon Rrotes: "Dishmohet që punëtorët që ndërtuen këto shtëpi ishin muratorë ose mjeshtra dibranë të cilët ishin shumë të njohur. ....Këto ustallarë ishin të veshun me dollama (veshje kombëtare, në formë pantallonash të gjana deri pak nën gju), me fesa tanuz në krye (fesa të kuq ngjyrë të mbylltë, jo të naltë, me nji tufë ngjyre blu të mbylltë qi ishte e kapun në majën e nji kordoni jo të trashë në të njajtën bojë si tufa), këpucë të kuqe. Karakteristika më e madhja e tyne ishte qeseri qi e mbajshin në brez. Ata ndërtojshin shtëpijat krejtësisht, pa inxhinier, ashtu në stilin e tyne (si i shohim edhe sot). Mjaftonte qi i zoti i shtëpisë tu diftonte dishirin dhe sasinë e odave, për me pasë nji shtëpi të ndërtueme. Ndër ustallarët që më bien ndër mend mue janë kenë të famshëm, ustah Jashari, ustah Muharremi, ustah Isaku, të cilët ishin teknikë të mirë në ndërtim muresh edhe me latue gurët me mjeshtri të madhe. Ndër katolike janë kenë vetëm Zef Marndreu, Pjeter Gjura, Lazer Sekuj, Mark Dibrani.

Roza nana e Zef Jubanit

Duket se të parët tonë i kanë dhanë randësi të madhe dyerve të oborrit tue shpenzue shumë për punimin e gurëve (të latuem) e të harqeve të bukur, qi sot napin karakteristikën ma të madhe kur i shohim rrugës. Gjithashtu dyert i kanë ba të gjana sa me hi qerrja për cdo nevojë qi ishte p.sh. me shti arkën e nuses, dru zjerrmi, bastan, rrushin prej vneshtet etj.

...nji kujtim i mirë që ka mbetë ndër shtëpijat shkodrane janë punimet me daltë, të bame prej dibranëve tonë sidomos prej mjeshtrit qi ia mbaj mend emnin: Dan Celiketa, i cili ka punue shtëpinë të Sahati i Inglizit, të Lord Pagjot-it. Këto punime gdhendje në dru paraqiten shumë të bukura dhe ekzakte në pikpamje të vizatimit si dhe simetrike si në tavane, trapazana, rafta, dyer. Kto lloj punimesh gjinden ndër shumë shpija të vjetra të Shkodres megjithëse stili i tyne perkon i gjithi me stilin Arab, Persian, Turk Oriental, me nji fjalë nji Bizantinizëm i plotë, qi me kohë vendi jonë i bani për vedi, i edukuem në atë mënyrë mbasi kishin kontakte të ngushta me popuj në kohnat e Turkisë.

Familja Jubani, e cila gëzonte reputacion të mirë dhe kulturë e shkollim përendimor, bëri ndryshime cilësore duke futur elementë dhe objekte moderne në hapsirat e banesës së tyre. Vëndosja e dyerve, dritareve, orendive cilësore e të kushtueshme të firmave të njohura europiane, i dha shtëpisë pamjen e një epoke e kulture tjetër, ndryshe nga stili oriental i banesës dhe ambienteve për rreth shtëpisë. Familja pat kontakte dhe miqësi me përsonalitete të vyer. Pjestarët e familjes kujtojnë që shpesh ndër odat e mëdha të shtëpisë, ku mblidheshin miq e të njohur, shfaqej film, ndigjohej muzikë e diskutohej për të rejat kulturore të kohës.

Edhe mjeshtri Simon Rrota në kujtimet e tija, shkruan për ndryshimet, modernizimin e ambienteve të mbrendëshme të shtepijave karakteristike të Shkodres.

...disa prej familjeve pasanike, tue kenë se shkojshin në Venedik (Venezia), mundoheshin me stilizue jetën me ndoj send tjetër qi shifshin atje si p.sh. ndonji pasqyrë të madhe me korniqe stilit barok etj. ...Por ma vonë, të rijtë qi delshin jashtë për studime e panë vedin se sa mbrapa ishim prej popujve tjerë, athere filluen me ba martesa "alla franca", me stolisë odat me mobilje, me ndërtue shpija moderne, tue lanë menjanë musandrat e trapazanat e tue marrë nji drejtim tjetër e ma të përparuem, simbas kohnave qi jetojmë sot.

Një vlerë tjetër e shtëpisë muze Jubani është se në këtë shtëpi lindi me 2 dhjetor 1910 Artisti i Popullit, aktori Zef Jubani, i njohur si Harpagoni shqiptar. Zefi ishte fëmija i katërt i Cinit dhe Rozës Jubani. I rritur në një ambient familjar ku muzika, letërsia e arti ishin pjesë e jetës, Zefi u bë një nga korifejtë e skenës teatrore shqiptare duke arritur kulmin me realizimin e roleve më të vështirë nga dramaturgjia kombëtare dhe botërore.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PREZIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Tiranë, më 21/11/1955

në 1950 i dekretit

Certifikatë

Nr. ZEF CIN JUBANI

Rekomandohet me "URDHËRIN E PUNËS TË KL. I-rë"

"QË AKTOR I TEATRIT PROFESIONIST "MIQESORI", KA INTERPRETUAR ME NJË CILËSI TË LARTË ARTISTIKE ROLIN QË I JANË DESHTRUAR, DUKE ARRITUAR NGA KJO ANË NË FUNDIN E TIJ TË FALENDËR DHE KRIJIMTARE ËA REALIZIMIN NË MJESTËRINË NË NJË KUALITET TË MIRË ARTISTIK TË GJITHË VEPRIMTARIVE".

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE
SHKODER

Keshilli i Bashkise Shkoder me vendimin Nr. 75 e dt 30.07.2008
I jep titullin Qytetar Nderi pas vdekjes
Zef Jubani
me kete motivacion

Artistit te amullt te Lenies Shqiptare,interpretuesit te shume roleve qe ndetet i pasurojne me Harpagonin te Komedise "Koprraci".

KRETARI
Bardhyl Lohja

Në qëndër të dhomës, në mes të ralikeve të familjes, më tërheq vemendjen një bust i aktorit i punuar me mjeshtri nga artisti shkodran Kolec Ljarja. Për ato që e kanë njohur Zef Jubanin, ngashmëria është e përkryer. Ndërsa, mbi dyshemenë e vjetër, përballë Zefit – Bust, bri oxhakut karakteristik oriental, i ruajtur në mëndyrën më të mirë të mundëshme, ndodhet djepi-shtrat ku u rritën pjestarët e familjes së Cinit, ndër to edhe Zefi.

Në muret e odës varen perlat e fisit, foto të vjetra, që janë historia e familjes e që duhet të jenë nga fillimet e fotografisë Marubi. Më e hershmja është ajo Zef Mesit me grue, më pas Matia i biri i Zefit me grue Ninen (viti 1878) dhe me familjen e tij e ndjekur nga fotoja familjare e Cin Jubanit me Rozen e fëmijet (ndër to edhe aktori Zef Jubani). Natyrshëm, po e mbyll këtë shkrim, duke pasë bindjen e krenarinë, që në Shkoder qytetaria jeton, në shumë familje të cilat janë dhe mbesin elitare, për kulturën e traditat familjare që trashëgojnë.

Vjene, me 18.09.2017